



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Mars 2023

Nr: 88

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË SHKODËR, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 3 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Shkodër

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Shkodër, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 18.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Shkodër.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 3 Mars 2023

Nr: 88

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Shkodër, për raportimin e veprimtarive publike”

“Me studentë të Fakultetit Ekonomik, degët Financë dhe Turizëm në universitetin “Luigj Gurakuqi”, të cilët po zhvillojnë praktikën në Bashkinë Shkodër”.

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=566890252124418&set=pcb.566891122124331>

Theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator, si dhe është publikuar në 1 (një) media.”

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 20.2.2023, bashkisë Shkodër i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 28.2.2023, bashkia Shkodër nëpërmjet postës elektronike ka dërguar bashkëlidhur shkresën nr. 2985 prot. datë 28.2.2023, ku ndër të tjera bën me dije se: *“...Kemi të bëjmë me një aktivitet të përvitshëm me studentë të cilët aktualisht zhvillojnë praktikën mësimore në bashkinë Shkodër. Kjo veprimtari është në vazhden e bashkëpunimit të përvitshëm të dy institucioneve me qëllim aftësimin e studentëve duke u njohur me funksionet dhe punën konkrete të institucionit...”*

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, mbështetur në tematikën e veprimtarisë që është zhvilluar, vlerësoj se veprimtaria e kryer nga kryetari i bashkisë Shkodër, nuk kategorizohet si veprimtari publike që ka nevojë për raportim, në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Shkodër, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Data: 3 Mars 2023

Nr: 88

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Shkodër, për raportimin e veprimtarive publike”

vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Shkodër.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI